



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 12-052/18-253, dt. 08.01. 2021

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL PËR VITIN 2020

JANAR- DHJETOR, 2020

Hyrje:

- Kuvendi i Komunës së Drenasit gjatë periudhës **Janar- Dhjetor 2020**, ka organizuar dhe mbajtur mbledhjet për Komitetin për Politik e Financa dhe mbledhjet e Kuvendit Komunal .

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, Kuvendi Komunal ka mbajtur **gjithsejtë 21 mbledhje**:

Prej tyre **11 mbledhje** të rregullta të Kuvendit, **5 mbledhje** Solemne, **2 mbledhje** Urgjente dhe **3 mbledhje** të jashtëzakonshme.

Për **11 mbledhje** të rregullta të organizuara të Kuvendit janë shqyrtuar , **(124)njëqind e njëzetekatër** pika të rendit të ditës dhe **(2)** dy pikë në mbledhjen urgjente, **(2)** dy pika për mbledhje të jashtëzakonshme, **(16)** gjashtëmbëdhjetë pika për mbledhje solemne gjithsejtë **(145),njëqind e dyzetepesë pika.**

Nga incizimet e seancave të Kuvendit janë bërë **15, procesverbale**, prej tyre **11, të mbledhjeve të rregullta të Kuvendit**, dy **(2) procesverbale të mbledhjes urgjente**, dhe **2 procesverbale të mbledhjeve të jashtëzakonshme.**

Sipas raportit të dt. **29.12.2020, Nr. 12-052/01-56538**, akteve të miratuara në Kuvendin Komunal të Drenasit janë gjithsejtë shtatëdhjetë e nëntë **(79)** akte prej tyre, Vendime shtatëdhjetë e dy **(72)**, Strategji një **(1)**, Plan zhvillimor një **(1)**, Kodi i Etikës një **(1)**, Rregullore Katër **(4)**.

1. Rregullore për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020. me Nr Protokolli **12/400/01-5912**, dt. **31.01.2020**. Me përmasime pas rekomandimeve të MAPL-së.
 2. Rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit, me Nr Protokolli **12-030/01-11633**, dt **03.03.2020**.
 3. Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës, nr protokolli **12-400/01-51554** dt **26.11.2020**.
 4. Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, nr protokolli **12-030 -56356**, dt. **28.12.2020**.
- Sipas Raportit të datës **30.12. 2020**, nr. **12-052-56802**, të akteve të dërguara për Ligjshmëri në MPL-së Janar –Dhjetor, Kuvendi i Komunës ka dërguar **55**, akte: prej tyre pesëdhjetë e një **(51)** Vendime dhe katër **(4)** Rregullore.
 - Sipas Raportit të Vendimeve të kthyer për rishqyrtim nga MPL dhe të harmonizuara në Kuvendin Komunal janë gjithsejtë dymbëdhjetë **(12)** vendime deri me datën **31.12. 2020**.
 - Vendime për krijim të Komisioneve Janar –Dhjetor janë gjithsejtë tre **(3)**.
 - Kuvendi I Komunës pas ç’do perfundimi të mbledhjes, Vendimet e miratuara në Kuvend I dërgon për Shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë autoritetit mbikëqyrës MPL-së, listën e akteve në bazë të neni 80, 80.1 i Ligjit Nr. 030 Për Vetëqeverisje Lokale, si dhe në bazë të Rregullores nr. **10/2019**, për shqyrtim administrativë të akteve të Komunave në MPL.

Kuvendi i Komunës ka të themeluara dy komitete obligative dhe katër komitete konsultative.

Komitete të obligueshme janë dy:

- 1 Komiteti për politik e Financa dhe
2. Komiteti për Komunitete.

Komitete Konsultative janë katër:

1. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport (**KKAKRS**),
2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (**KKZHEMASHMS**),
3. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuar (**KKPAK**) dhe
4. Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore (**KKBGJ**).

- **Komiteti për Politikë dhe Financa** - gjatë periudhës Janar-Dhjetor ka mbajtur: **12**, mbledhje prej tyre **11**-mbledhje të rregullta dhe një (1) mbledhje e **Jashtëzakonshme** ku pas çdo përfundimi të mbledhjes janë, **përpiluar 11 rekomandime** me shkrim për Kuvend.

- Për dymbëdhjetë mbledhje të organizuara të Komitetit për Politikë dhe Financa nga incizimet e mbledhjeve janë bërë (12) dymbëdhjetë **procesverbale**, njëmbëdhjetë (11), **procesverbale të mbledhjeve të rregullta dhe një (1) procesverbal i mbledhjeve të jashtëzakonshme**.

- Janë shqyrtuar **101, njëqind e një** pika të rendit të ditës gjithsejtë, prej tyre (1) një **jashtëzakonshme**.

- **Komiteti për Komunitete** gjatë periudhës Janar - Dhjetor ka mbajtur: **7**, mbledhje.

1. Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (KKAKRS), gjatë periudhës Janar - Dhjetor ka mbajtur 6, takime dhe ka dorëzuar 6 procesverbale të mbledhjeve me lista të pjesëmarrësve.

2. Komitetin Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (KKZHEMASHMS), gjatë periudhës Janar - Dhjetor ka mbajtur 6, takime dhe ka dorëzuar 6 procesverbale të mbledhjeve me lista të pjesëmarrësve.

3. Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara (KKPAK), gjatë periudhës Janar - Dhjetor ka mbajtur 6, takime dhe ka dorëzuar 6 procesverbale të mbledhjeve me lista të pjesëmarrësve.

4. Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore (KKBGJ), gjatë periudhës Janar - Dhjetor ka mbajtur 6, takime dhe ka dorëzuar 6 procesverbale të mbledhjeve me lista të pjesëmarrësve.

- **Komuna e Drenasit ka Të lidhura (7) shtatë marrëveshje për bashkëpunim ndër komunal në** fushën e infrastrukturës me komuna tjera siç janë: Komuna e Skenderajt, Komuna e Vushtrrisë, Komuna e Obiliqit, Komuna e Fushë Kosovës, Komuna e Lipjanit, Komuna e Malishevës, dhe Komuna e Klinës. **Gjatë vitit 2020, zyra e Kuvendit ka pranuar gjashtë (6), kërkesa për vërtetime të përvojës së punës në Kuvend, ku ka lëshuar, 6 vërtetime.**

Sipas Raportit vjetor nr. 12-052/01-127, dt. 05.01.2021, për të gjitha lëndët e dërguara gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020, në arkiv Komunal kemi dorëzuar gjithsejtë 226, lëndë pa i llogaritur kërkesat për emërim të rrugëve pasi janë të pa kryera procedurat e shqyrtimit .

- **Është bërë përshkrimi brenda dhe jashtë në mbështjellëse të lëndëve dhe mbyllja për së cilën lëndë me laps kimik për të dorëzua në arkiv gjithsejtë 226 lëndë, dhe për 91 kërkesa të pa shqyrtuara, gjithsejtë 317, lëndë, ku të gjitha janë të regjistruara në fletore të protokollit.**

Kërkesa drejtuar **Komisionit për Emërim të Rrugëve** të pranuar në zyrën e Kuvendit, për emërim të ri të emrave të rrugëve dhe ndryshim të emrave të cilat janë emëruar më herët janë: gjashtëdhjetetë (68), të vitit 2017, njëzetënjë (21), të vitit 2018, nëntëdhjetë e dy (92), të vitit 2019, dhe 4, janë pa vit të shënuara, shtatëdhjetë e katër (74) janë të Vitit 2020, sipas regjistrimit të përpiluar nr. 12-030/01-56587.

- **Gjithsejtë kërkesa të pa shqyrtuar nga Komisioni janë: dyqind e pesëdhjetë e nëntë, (259), kërkesa Në sistem të intranetit janë aprovuar të gjitha lëndët e regjistruara të vitit 2020 si dhe ju kanë bashkangjitur dokumentet siç janë :Shkresat e dërgimit të akteve në MPL, Raportet e kthyer nga MPL për vendimet, Ligjshmëritë e kthyer nga MAPL-ja për vendimet, Faturat e shpenzimeve, vërtetimet e lëshuara sipas kërkesave, dhe vendimet në gjuhën serbe.**

Zyra e Kuvendit ka raportuar me raporte MPL-së, tremujore gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore brenda vitit 2020. Kryesisht përpilon 6-gjashtë raporte të ndryshme siç janë:

1. Raporti i të gjitha akteve të miratuara në Kuvend, 2. Raportin e akteve të dërguara për Ligjshmëri në Kuvend. 3. Raportin e lëndëve të dorëzuara në arkivin e Komunës, 4. Raportin e akteve të kthyer nga MPL për rishqyrtim, 5. Raportin e funksionimit të Kuvendit dhe Komunë me përgjigjeje nga pyetjet e MPL, 6. Raportin e Përgjithshëm të Punës së zyrës së Kuvendit .

Paraqitja e detajuar e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës në mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Politik dhe Financa dhe mbledhjet e Kuvendit si dhe aprovimi i Raporteve dhe Vendimeve të Kuvendit Komunal të aprovuara gjatë periudhës janar-dhjetor 2020

Janar, 2020

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 24.01.2020, janë shqyrtuar (8) tetë pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet e KPF për Kuvend.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 31.01.2020, ku janë shqyrtuar (10)dhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar (3) tri vendime:

1. Betimi i asamblistit të ri Përparim Bajraktari nga Partia e subjektit politik, Vizioni për Drenasin, pas dorëheqjes së asamblistit Endrit Gllarevea në Kuvendin Komunal Drenas.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 27.12.2019.
3. Draft Propozim strategjia e zhvillimit ekonomik Lokal 2020 -2024.
4. Propozim **Vendim** për shqyrtimin publik të Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Drenasit për periudhën 2020-2028.
5. Plani vjetor i Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020
6. Raporti vjetor i Komiteteve Konsultative për vitin 2019:
 - a. Komiteti për Arsim Kulturë Rini dhe Sport.
 - b. Komiteti për Zhvillim Ekonomik Mbrojtje të Ambientit Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
 - c. Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizua.
7. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit janar – dhjetor 2019.
8. Njoftim rreth përfundimit të kontratave të shfrytëzimit të pronave të paluajtshme në Komunën e Drenasit.
9. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020. E plotësuar.
10. Të ndryshme.

Kuvendi Komunal Drenas përbehet nga 31 asamblist, pas dorëheqjes se z. Endrit Gllareva, gjatë mbledhjes së mbajtur më **31.01.2020**, u zëvendësuan më: Përparim Bajraktarin nga subjekt politik Vizioni për Drenasin.

Shkurt, 2020

Mbledhja Solemne e Kuvendit Komunal për nderë të Ditës së Pavarësisë së Kosovës , është mbajtur më:17.02.2020, me këtë rend dite:

1. Hapja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës nga Kryesuesi Labinot Halilaj.
2. Fjalimi I Kryetarit të Komunës Ramiz Lladrovci.
3. Mbyllja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 21.02.2020, janë shqyrtuar (7)shtatë pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet e KPF për Kuvend.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 28.02.2020, ku janë shqyrtuar (8) tetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar (3) Tri vendime dhe (2)Rregullore:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 31.01.2020.

2. Propozim **Vendim** për miratimin e Propozimit Profesional për Shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit.
3. Rregullore për Organizimin e Punës në institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Drenasit.
4. Raporti vjetor i punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale për vitin 2019.
5. Propozim **vendim** për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas.
6. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020. E plotësuar.
7. Propozim **Vendim** për caktimin e qirasë joprofitabile për përfituesit e programit të veçantë të banimit.
8. Të ndryshme.

Mars, 2020

Mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunave të zonës së Drenicës kushtuar "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rënies Heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë të rënëve për Liri" është mbajtur e përbashkët në Kuvendin e Skenderajt me 05.03.2020.

1. Hapja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës së Skenderajt nga Kryesuesja znj. Fatbardha Haliti.
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci.
3. Mbyllja e mbledhjes solemne të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunal për organizimin e javës për promovimin e të drejtave të grave me rastin e "8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas, është mbajtur me dt. 09.03.2020

1. Hapja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës së Drenasit nga Kryesuesi;
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci;
3. Fjalime tjera për nder të "8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas";
4. Mbyllja e mbledhjes solemne të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 20.03.2020, janë shqyrtuar pesë (5), pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë bërë rekomandimet e KPF për Kuvend.

Mbledhja Urgjente e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 25.03.2020, ku janë shqyrtuar (1) një pikë e rendit të ditës dhe është miratuar (1) një vendim:

1. Propozim **Vendim** për bartjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Mbledhja e Urgjente me votim onlajn përmes emailit e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 27.03.2020, ku janë shqyrtuar një (1) pikë të rendit të ditës dhe është miratuar një (1) vendim:

1. Ndryshim i Propozim **Vendim** për bartjen e mjeteve financiare për menaxhimin e situatës së krijuar nga virusi COVID-19, me rekomandim të MAPL-së me ndryshime.

Prill, 2020

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 30.04.2020, ku janë shqyrtuar nëntë (9) pikë të rendit të ditës dhe janë miratuar pesë (5) vendime:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 28.02.2020.

2. Propozim **Vendim** për lirim nga taksa Komunale për bizneset që operojnë në Komunën e Drenasit për vitin 2020.
3. Propozim Vendim i statutit për ndërmarrjen publike Lokale “Stacioni i autobusëve”, SH. A. në Drenas-Glllogoc.
4. Propozim **Vendim** për formimin e komisionit për vlerësimin e pronave që mund të këmbehen dhe dhënien e rekomandimeve për pronat që duhet të shpronësohen në parcelën 743/1, në zonën e kadastrave Drenas.
5. Diskutim rreth situatës emergjente e krijuar nga COVID-19, dhe mundësitë e ndarjes buxhetore për tejkalim të situatës në Komunën e Drenasit.
6. Draft propozim për ndryshim-plotësimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024.
7. Propozim **Vendim** për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020.
8. Raporti Financiar i zhvillimit të Buxhetit Janar-Mars 2020.
9. Të ndryshme.

Maj, 2020

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 20.05.2020, janë shqyrtuar pesë (5), pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet e KPF për Kuvend.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 27.05.2020, ku janë shqyrtuar shtatë (7) pika të rendit të ditës dhe janë miratuar katër (3) vendime (1) një Rregullore:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. **30.04.2020**.
2. Propozim **Vendim** për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.
3. Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.
4. Propozim **Vendim** për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020, me ndryshime.
5. Propozim **vendim** për miratimin e Statutit të ri të QKMF-së Drenas me ndryshime
6. Draft-Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngastra dhe Gjoha 2020, me ndryshime.
7. Të ndryshme.

Qershor, 2020

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 10.06.2020, ku janë shqyrtuar dy(2) pika të rendit të ditës dhe janë miratuar dy (1) vendim dhe një Kërkesë e Komisionit:

1. Propozim **Vendim** për Rishikim të buxhetit për vitin 2020.
2. Kërkesë për aprovimin e kandidatëve për komision në përzgjedhjen e drejtorëve/zv drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore në Drenas.

Mbledhja Solemne e Kuvendit Komunal, për nder të 14-Qershorit Ditës së Çlirimit të Drenasit, është mbajtur më: 14.06.2020, me këtë rend të ditës.

1. Hapja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës nga Kryesuesi - Labinot Halilaj.
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit - Ramiz Lladrovci.
3. Mbyllja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 22.06.2020, janë shqyrtuar (15) pesëmbëdhjetë pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet e KPF për Kuvend.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 29.06.2020, ku janë shqyrtuar (16) gjashtëmbëdhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar (12) njëmbëdhjetë vendime:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.05.2020.
2. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për KB „Feronikeli”.
3. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për KF „Drenasi”.
4. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për KV „Feronikeli”.
5. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për KH „Drenica”. (M).
6. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për KF „Feronikeli”.
7. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për SHKA „Shote Galica”.
8. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për OJQ „Shqipet e Drenicës”.
9. Propozim **Vendim** për Financimin e Projektit për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL)-Drenas.
10. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
11. Propozim **Vendim** për miratimin e planit zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028.
12. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2021-2023.
13. Propozim **Vendim** për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrave.
14. Propozim **Vendim** për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në parcelën 2048/0 e cila është në zonën kadastrale në Zabel i Epërm dhe parcelën 235/0 e cila është në zonën kadastrale në Abri të Epërme.
15. Propozim **Vendim** për ndryshimin e anëtarëve të KKSB-së.
16. Të ndryshme.

Korrik, 2020

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 08.07.2020, ku është shqyrtuar (1) një pikë e rendit të ditës dhe është miratuar në mënyrë unanime.

1. Miratimi i deklaratës në mbrojtje të vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 24.07.2020, janë shqyrtuar (14) trembëdhjetë pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet e KPF për Kuvend.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 30.07.2020, ku janë shqyrtuar (14) katërmëdhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar (10) dhjetë vendime:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 29.06.2020.
2. Propozim **Vendim** për shpalljen e Lokalitetit të Boshtres (FORSYTHIA EUROPEA) në zonën e Goleshit- Fshatin Sankoc në Kategorinë- Monument i Natyrës, (e plotësuar).
3. Propozim **Vendim** për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glllogocit 2020-2028, (e plotësuar).
4. Njoftim rreth përfundimit të kontratës së shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës së Drenasit.
5. Propozim **Vendim** për definimin dhe parcelizimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhen në prona komunale në Komunën e Drenasit.

6. Propozim Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit nr.12-353-22880, të datës 29.06.2020 për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e dy fushave sportive, në pronën komunale, në zonën kadastrale në Abri e Epërme dhe në zonën kadastrave në Zabel i Epërm.
7. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrave në Baicë.
8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja joprofitabile për familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2020.
9. Propozim Vendim për caktimin e Lokacioneve për ndërtimin modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të studionit të qytetit "Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.
10. Propozim Vendim për caktimin e Lokacionit për realizimin e Projektit për ndërtimin e Çerdhes në Komoran.
11. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm Publik për kthimin e pronave të cilat janë nën menaxhimin e AKP-së, në zonat Kadastrale : Qikatovë e Re, Terstenik, Poklek , Korroticë e Poshtme, Zabel i Poshtëm, Komoran dhe Sankoc.
12. Raporti Financiar i Zhvillimit të Buxhetit Janar Qershor 2020.
13. Propozim Vendim për Shpalljen e interesit të Përgjithshëm Publik të pjesës së ngastrës kadastrave 120/0, për zgjerimin, modernizimin dhe kompletimin e infrastrukturës përcjellëse të Stadionit në qytetin e Drenasit " Rexhep Rexhepi" në Poklek të Ri.
14. Të ndryshme.

Gusht, 2020

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 24.08.2020, janë shqyrtuar (4) katër pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet nga KPF për Kuvend.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 28.08.2020, janë shqyrtuar (1) një pikë e rendit të ditës.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 31.08.2020, ku janë shqyrtuar (4) katër pika të rendit të ditës dhe është miratuar (1) një vendim:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.07.2020.
2. Raporti i punës së Kryetarit Janar –Qershor 2020.
3. Propozim Vendim për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik /juridik.
4. Të ndryshme.

Shtator, 2020

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 16.09.2020, janë shqyrtuar (10) dhjetë pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet nga KPF për Kuvend.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 23.09.2020, ku janë shqyrtuar (13) trembëdhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar (6) gjashtë vendime:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 31.08.2020.
2. Propozim Vendim i Buxhetit të Komunës për vitin 2021 dhe parashikimi i Buxhetit për vitet 2022-2023.
3. Propozim Vendim për këmbimin e njërive të ndërtesave (banesave) në zonën Kadastrale në Glllogoc.
4. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave-Banesat), në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Drenas.

5. Propozim Vendim për shfuqizimin e vendimit për definimin dhe parcializimin e të gjitha varrezave të cilat ndodhën në prona komunale në Komunën e Drenasit.
6. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit, për vendosjen e Bustit të Heroit të Kombit Fetah Kiqina.
7. Raporti i zyrës Kombëtare të Auditimit.
8. Plani i implementimit të rekomandimeve të zyrës Kombëtare të Auditimit.
9. Raporti i proformancës Komunale për vitin 2019.
10. Raporti periodik i zbatimit të rekomandimeve të ZKA.
11. Propozim Vendim për transferin e rezervës buxhetore.
12. Raport nga DKA për ecurin e procesit mësimor.
13. Të ndryshme.

Tetor, 2020

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 23.10.2020, janë shqyrtuar (11) njëmbëdhjetë pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet e KPF për Kuvend. Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 30.10.2019, ku janë shqyrtuar (16) gjashtëmbëdhjetë pika të rendit të ditës, pika 10-të, u heqë nga rendit i ditës dhe janë miratuar (12) vendime:

1. Betimi i asamblistit/ës së re znj. Antigona Istogu nga Partia Demokratike e Kosovës „PDK” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal pas dorëheqjes znj. Arta Xhylani në Kuvendin Komunal Drenas.
2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 23.09.2020.
3. Raporti Financiar i Zhvillimit Të Buxhetit Janar Shtator 2020.
4. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit 12-400-40369, të datës. 23.09.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
5. Propozim Vendim shfuqizimin e Vendimit 12-400-40360, të dt. 23.09.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
6. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave), në parcelën nr. 743-1, në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
7. Propozim Vendim për këmbimin e pronave të paluajtshme (ndjesive të ndërtesave-banesave) në parcelën nr. 743-1, në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
8. Propozim Vendim për shpronësimin e pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave –banesave) në parcelën nr. 743-1, në zonën kadastrave në Drenas (Gllogoc).
9. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave të paluajtshme të hekurudhave të Kosovës (Shoqëri Aksionare) për parcelat nr. 953-1, 961-0, 956-0, të cilat ndodhen në zonën kadastrale Drenas (Gllogoc).
10. Propozim Vendim për transfero të mjeteve nga projekti rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese dhe rregullimi i sheshit të qytetit në projektin mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike.
11. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme ish shoqërore të OP-Drenicës, të cilat janë nënë menaxhimit të AKP-së, në zonën Kadastrale Korroticë të Epërme.
12. Propozim Vendim për dhënien afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Fer Petrol.

13. Propozim Vendim për dhënie afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës për Kompaninë Elkos shpk.
14. Propozim Vendim për dhënie afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës personit fizik Ragip Veseli.
15. Propozim Vendim për dhënie afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës ,zona kadasatrale Arllat për Kompaninë IP Kos shpk.
16. Propozim Vendim për dhënie afatgjatë prej nëntëdhjetenëntë (99) vite të Pronës së Paluajtshme të Komunës zona kadastrave Gllogoc për Kompaninë IP Kos shpk.
17. Të ndryshme.

Nëntor,2020

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 19.11.2020, dhe janë shqyrtuar (8) tetë pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes përgatitën rekomandimet nga KPF.

Mbledhja e Solemne për nder të 28 Nëntorit, Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, e Kuvendit Komunal Drenas në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Skenderajt, është mbajtur më:28.11.2020, me këtë rend të ditës.

1. Hapja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës nga Kryesuesi - Labinot Halilaj.
2. Fjalimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit - Ramiz Lladrovci .
3. Mbyllja e mbledhjes Solemne të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 26.11.2020, ku janë shqyrtuar (12) dymbëdhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar (8) tetë vendime, (1) një Rregullore dhe Kodi i Etikës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 30.10.2020.
2. Propozim Rregullore për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Propozim Vendim për rrënimin e ish objektit të Komunës,si dhe objekteve tjera përcjellëse.
4. Propozim Vendim për bashkimin dhe parcelizimin e parcelave kadastrale.
5. Propozim Vendim për këmbimin e parcelave në zonën kadastrate Gllogoc.
6. Kodi i Etikës.
7. Propozim Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.
8. Propozim Vendim për transferin e mjeteve të Kategorisë subvencione dhe transfere.
9. Propozim Vendim për shpronësimin e njërive të ndërtesave-banesave, në zonën kadastrave në Gllogoc.
10. Propozim Vendim për miratimin e listës së veçantë të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.
11. Propozim Vendim për plotësim-ndryshim të vendimit Nr. 12/400/01-29727, me29/07/2019 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL-SH .A Stacioni i Autobusëve –Gllogoc.
12. Të ndryshme.

Dhjetorë,2020

Mbledhja e Komitetit për Politik dhe Financa është mbajtur me datën 21.12.2020, janë shqyrtuar trembëdhjetë (13) pika të rendit të ditës. Pas mbledhjes janë përgatit rekomandimet e KPF për Kuvend.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal është mbajtur më: 28.12.2020, ku janë shqyrtuar (13) trembëdhjetë pika të rendit të ditës dhe janë miratuar (5) pesë vendime e (1)një rregullore:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas të dt. 26.11. 2020.
2. Plani i Punës për vitin 2021, i Kuvendit Komunal.
3. Plani i Punës të Kryetarit për vitin 2021.
4. Propozim Rregullore për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës.
5. Plani preliminar i Prokurimit për vitin 2021.
6. Diskutimi i Planit të Integritetit.
7. Propozim Vendim për financimin e Projektit “Ngritja e Mirëqenies Sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Familjarëve të tyre.
8. Propozim Vendim për lirim nga qiraja jo profitabile, familjet përfituese të shfrytëzimit të përkohshëm të banimit social në Bllokun I dhe II në Drenasin III për vitin 2021.
9. Propozim Vendim për këmbimin e njësive kadastrave nr. 348/0 dhe 1011/0 në zonën kadastrale në Gllogoc.
10. Propozim Vendim për përmisimin e gabimit teknik në listën e veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë në vitin 2021.
11. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e peronizimit për kompanitë e transportit publik të udhëtarëve me autobus për linjat urbanë- periferike dhe ndër urbane që shfrytëzojnë stacionin e autobusëve në Gllogoc, për operim.
12. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.
13. Të ndryshme.



Shefe e zyrës së Kuvendit

Zahrie Podrimqaku Subashi
Zahrie Podrimqaku Subashi